



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenit 18, paragrafi (3) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

V E N D I M

për rregullat e qeverisjes së mirë korporativ në bankë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 113/19)

1. Në vendimin për rregullat e qeverisjes së mirë korporative në bankë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/18), në pikën 3), nënpikën 3.4), pas fjalës: "bankë" shtohen fjalët: "të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore)".

2. Në pikën 5), paragrafi (2) fjalët: "të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore)", fshihen.

3. Pika 6), paragrafi (1), nënparagrafi (1) ndryshohet si më poshtë:

"- të miratojë politikën e biznesit dhe planin e zhvillimit të bankës dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre;

Në nënparagrafin (7), pas fjalëve: "kapitali i brendshëm" vendohet presje dhe shtohen fjalët: "procesi i përcaktimit të likuiditetit të brendshëm".

4. Në pikën 3), nënpika 3.16), në pikën 7), paragrafi (2), në pikën 25), paragrafi (3), në titullin e kreut XI dhe në pikën 61) fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut".

5. Në pikën 16), paragrafi (3) ndryshohet si më poshtë:

"Kryetari i këshillit të përcaktuar me ligj nuk mund të jetë kryetar i një bordi tjetër të përcaktuar me ligj ose i një bordi tjetër nga pika 17) e këtij vendimi".

6. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/VI-2/2019
30 maj 2019
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska